



**AUTORITETI KOMBËTAR
PËR SIGURINË KIBERNETIKE**

**CVE-2026-6787
CVE-2026-6788
CVE-2026-41288
CVE-2026-41286
CVE-2026-41287**

Dobësi të Shumta në WatchGuard Agent për Windows

Data: 07/05/2026
Version: 1.0

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	2
Informacione Teknike	2
Rekomandime	2
Referenca	3

Përmbledhje Ekzekutive

Janë identifikuar disa dobësi me rrezik të lartë në WatchGuard Agent për Windows, të cilat mund të shfrytëzohen për eskalim privilegjesh ose ndërprerje të funksionalitetit të sigurisë së endpoint-eve. Sulmuesit lokalë mund të fitojnë privilegje SYSTEM, ndërsa sulmuesit në të njëjtin rrjet lokal mund të shkaktojnë ndërprerje të shërbimit përmes paketave të manipuluar posaçërisht.

Informacione Teknike

Dobësi me Rrezik të Lartë

• CVE-2026-6787 & CVE-2026-6788 – Eskalim Privilegjesh në WatchGuard Agent Service

Një grup dobësish ekziston në shërbimin WatchGuard Agent që mund të kombinohen për të anashkaluar kontrollet e sigurisë. Një sulmues lokal mund t'i shfrytëzojë këto dobësi për të kaluar nga privilegje standarde përdoruesi në privilegje SYSTEM, duke çuar në komprometim të plotë të sistemit.

• CVE-2026-41288 – Caktim i Gabuar i Lejeve në Komponentin e Menaxhimit të Patch-eve

Një konfigurim i gabuar i lejeve në komponentin e menaxhimit të patch-eve të WatchGuard Agent lejon një përdorues lokal të autentikuar të manipulojë operacionet e shërbimit dhe të eskalojë privilegjet në nivelin SYSTEM.

• CVE-2026-41286 & CVE-2026-41287 – Stack-Based Buffer Overflow në Discovery Service

Ekzistojnë disa dobësi të tipit stack-based buffer overflow në WatchGuard Agent Discovery Service. Një sulmues i paautentikuar në të njëjtin rrjet lokal mund t'i shfrytëzojë këto dobësi duke dërguar paketa të krijuara posaçërisht, duke shkaktuar mohimin e shërbimit (DoS), rrëzimin e shërbimit dhe ndërprerjen e funksionalitetit të sigurisë së endpoint-eve.

Produktet E Prekura

- WatchGuard Agent për Windows versionet deri dhe përfshirë 1.25.02.0000

versionet e korrigjuara / masat zbutëse

- WatchGuard Agent për Windows versioni 1.25.03.0000

Rekomandime

AKSK rekomandon përditësimin e versioneve të prekura në versionin e korrigjuar ose në versionin më të fundit të publikuar nga WatchGuard.

Referenca

- <https://www.watchguard.com/wgrd-psirt/advisory/wgsa-2026-00010>
- <https://www.watchguard.com/wgrd-psirt/advisory/wgsa-2026-00011>
- <https://www.watchguard.com/wgrd-psirt/advisory/wgsa-2026-00012>
- <https://www.watchguard.com/wgrd-psirt/advisory/wgsa-2026-00013>